

VENDIM
Nr. 337, datë 16.5.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 522, DATË 30.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR QËLLIM TË NDËRTIMIT, PRONËSISË, SHFRYTËZIMIT, MIRËMBAJTJES DHE TRANSFERIMIT NË FAVOR TË SHTETIT TË PROJEKTIT TË NJË HIDROCENTRALI TË RI NË ASHTË, NË QARKUN E SHKODRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 522, datë 30.6.2010 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme prej 51 247 (pesëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e shtatë) m² tokë, arë, truall, ullishte, pemëtore, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 42 925 054 (dyzet e dy milionë e nëntëqind e njëzet e pesë mijë e pesëdhjetë e katër) lekë.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 42 925 054 (dyzet e dy milionë e nëntëqind e njëzet e pesë mijë e pesëdhjetë e katër) lekësh të përballohet nga fondet e shoqërisë “Energji Ashta”, sh.p.k. si subjekt kërkues i këtij shpronësimi.”.

3. Në tabelën e të shpronësuarve, që i bashkëlidhet vendimit, prona me nr. 109/1, në emër të shtetasit Jak Lazër Ndoci, bëhet në emër të shtetasit Ndrek Zef Caka, prona me nr. 130/1, në emër të shtetasit Mark Ndoci, bëhet në emër të shtetasit Tom Pjetër Kola dhe prona me nr. 18/1 hiqet nga tabela e shpronësimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha